



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO**

---

27 shtator 2019

C-IV-13-2170

*Ankuesi*

H.D. Gllogoc.

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, gjyqtarja Manushe Karaqi, me 27 shtator 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN052-1898, i datës 24 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 10 tetor 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër shkresës nr. PRN052-1898, të datës 13 shtator 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara nga NSH (në likuidim), për periudhën e vitit 1998-1999, me kamatë ligjore siç llogarisin bankat në Kosovë në afat për destinim për një vitë, si dhe njofton se, ka realizuar vlerën e 20%, nga likuidimi i NSH. Më tej citon se, me datë 17 korrik 2007, përmes Sindikatit tonë kemi paraqitur kërkesën për realizimin e të drejtës sime, sipas udhëzimit të sindikatit të punëtorëve, duke cituar tutje se, kërkesat e disa punëtorëve të tjerë të natyrës së njëjtë i ka aprovuar Komisioni Shqyrtues i Likuidimit, ndërsa kërkesën time e ka refuzuar.

Gjykata ka marr në shqyrtim paraprak ankesën e ankuesit, si dhe me urdhër të datës 27 shkurt 2014, urdhërohet ankuesi që gjykatës ti parashtrij kopjen e vendimit të AKP, kundër të cilit është parashtruar ankesa dhe dëshmi se kur është pranuar vendimi i tillë.

Me 18 korrik 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se, i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesë, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, po ashtu e paditura ka pohuar se ankuesi kishte parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave në AL, jashtë afatit të paraparë ligjor. E paditura ka pohuar se e drejta që kërkohet, është parashkruar në pajtim me afatin e aplikueshëm të parashkrimit.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse shkresa e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN052-1898, i datës 13 shtator 2013, gjegjësisht Vendimi PRN052-1898, i datës 24 qershor 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1, të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë kryesore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKM-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH kishte hyr në proces të likuidimit nga data 4 korrik 2006. AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 26 shtator 2006. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor "Koha Ditore" me 26 korrik 2006 dhe në ëeb sajtin e AKM-së.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 17 korrik 2007, përmes sindikatës së punëtorëve.

Me shkresën PRN052 -1898, të datës 13 shtator 2013, Autoriteti i Likuidimit, iu është përgjigjur ankuesit me shkresën në përmbajtje se, ankuesi kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashkrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKM-ja. Ankuesi në ankesë nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit, mandej nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës, si dhe kërkuar nga ankuesi që të ofrojë informacione shtesë dhe atë brenda 15 ditëve, pasi të keni pranuar këtë njoftim, se nëse nuk ofrohet informacioni i kërkuar, AL do ta vlerësoj kërkesën tuaj mbi bazën e informacionit që posedon aktualisht.

Me urdhër të datës 27 shkurt 2014, gjykata ka urdhëruar ankuesin që ti parashtroj kopjen e vendimit të AKP, kundër të cilit është parashtruar ankesa dhe dëshmi se kur është pranuar vendimi i tillë, të cilën urdhër me datë 05 mars 2014, e ka pranuar ankuesi, për të cilin nuk është përgjigjur.

Me 18 korrik 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, të cilën shkresë - mbrojtje ankuesi a ka pranuar me datë 01 gusht 2018.

Pas marrjes në shqyrtim të lëndës gjykata vënë re se, pala ankuese ka paraqitur ankesën kundër shkresës PRN052 -1898, të datës 13 shtator 2013, e cila nuk ka qenë vendim me të cilën është refuzuar kërkesa e ankuesit, dhe i cili mund të ankimohet në gjykatë, por bazuar në përmbajtjen e shkresave të lëndës, si dhe sigurimit të vendimit PRN052 -1898, të datës 24 qershor 2014, nga e paditura. Gjykata konsideroi se ankesa e ankuesit atakon vendimin e datës 24 qershor 2014, me të cilin refuzohet si e pa vlefshme kërkesa e ankuesit, si dhe me të cilin kërkon kompensimin për paga të pa paguara, andaj nga shqyrtimi i mëtejshëm konstaton se:

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 26 shtator 2006, e deri në datën e parashtrimin të kërkesës së tij me 17 korrik 2007 në Autoritetin e Likuidimit, kanë kaluar më shumë se dhjetë muaj, ndërsa shkresës së AL, për plotësim me informacione shtesë nuk ju keni përgjigjur. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesit nuk iu është caktuar taksa gjyqësore, pasi që nuk caktuar vlera e kërkesës.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Manushe Karaqi**  
Gjyqtare

### **Urdhër për zyrën e regjistrimit**

Aktgjykimi duhet t'i dorëzohet palëve.